

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Bindja / el-Jekiin / اليقين

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَفِي الْأَرْضِ آيَاتٌ لِّلْمُوقِنِينَ"

"Në tokë ka shenja për të bindurit (në besim)." (edh-Dhaarijaat, 20)

Bindja është transportuesi i udhëtarit në shtegun e pastrimit shpirtëror. Ky është fundi i shkallëve të besimtarëve të rëndomtë, kurse për elitën e besimtarëve është shkalla e parë.¹ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është bindja e dijes (*ilmul-jekiin*)² dhe kjo nënkupton:

- Ta pranosh atë që është bërë e qartë nga i Vërteti.³
- Ta pranosh atë që është fshehur nga i Vërteti.⁴
- Ta pranosh tërë atë që është vërtetuar për të Vërtetin.⁵

¹ Ngaqë të gjitha shkallët (stacionet) e tyre janë të varura nga vendosja e bindjes. Mirëpo, gjithmonë ka bindje të cilën duhet aspiruar. Qe bindja ajo, që dalloi Ebu Bekrin nga të tjerët. Megjithatë, bindja e tij nuk mund të krahasohet me atë të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Edhe Ibrahimî ﷺ kërkoi më shumë bindje, kur i kërkoi Allahut t'ia demonstronte ringjalljen e të vdekurit. Këtë e bëri edhe Musa ﷺ, kur i kërkoi Allahut ta shihte.

² Shpesh përkthehet si dija e bindjes. Këtu përzgjedha të jetë "bindja e dijes", meqë bindja është tema për të cilën po flitet. Pra, kjo nënkupton bindjen që bazohet në dije (të sigurt).

³ Tërë e vërteta që na u përcoll nëpërmjet pejgamberëve ose që na tregohet në univers.

⁴ Kjo është dija për të padukshmen, për të cilën ne besojmë atë që na është thënë me anë të Shpalljes, dhe t'i dorëzohet Allahut ajo që nuk kuptojmë. Për shembull, ne besojmë në ndëshkimin e varrit, por ia lëmë dijes së Allahut natyrën e vërtetë të këtij ndëshkimi.

Bindja e të parit (*ajnel-jekiin*). Kjo ndodh atëherë kur:

- Përjetimi (i hyjnores) ta zëvendësojë nevojën për prova.⁶
- Të parët ta zëvendësojë të dëgjuarit.⁷
- Të parët (e hyjnores) ta shpojë vellon e dijes.⁸

Bindja e realitetit (*hakkul-jekiin*).⁹ Kjo është:

- Shkëlqimi i dritës së zbulësës.¹⁰
- Heqja qafesh e barrës së bindjes.¹¹
- Shpërbërja në të vërtetën e sigurt.

⁵ Për tiparet dhe veprimet e Tij, pa shtrembërim (*tahrif*), pa mohim (*ta'til*), pa përngjasim (*temthil*), pa krahasim (*teshbih*). Siç do të thoshin paraardhësit e devotshëm: “Lëri (përmendjen e tipareve në Shpallje) ashtu siç janë,” pra pa i mohuar dhe pa i diskutuar si janë ato (natyrën e vërtetë të tyre).

⁶ Besimi i ndërlidhur me përvojën (përjetimet) konfirmon besimin përtej fushës së bindjes intelektuale. Tash, ndjekësi i shtegut të pastrimit shpirtëror nuk ka nevojë për prova. Duhet të thuhet se provat e shumta ta shtojnë bindjen dhe aftësia më e madhe për ta dalluar të vërtetën nga e pavërteta (*furkaan*) të jep imunitet përballë të pavërtetës.

⁷ Ndjekësit e shtegut të pastrimit shpirtëror tash shohin atë që u është përshkruar.

⁸ Tejkalimi i kufijve të dijes njerëzore nëpërmjet të parët me sytë e zemrës të realitetit hyjnor me anë të ndihmës hyjnore.

⁹ Një shembull i shtresave të ndryshme është besimi ynë në xhenetin. Kjo bazohet në pranimin tonë të mesazhit të peygamberit ﷺ dhe kjo është bindje e bazuar në dije, ndonëse ne ende dallojmë brenda kësaj shtrese. Peygamberi ﷺ pa xhenetin në *Israa* (ngritjen në qiell), kështu që bindja e tij është ajo e të parit me sy. Kur ne hymë në xhenet – Allahu na e mundësoftë! -, bindja jonë do të jetë e bazuar në realitetin. Kurse kjo fazë në këtë botë u përket të Dërguarve të më të mëdhenj të Allahut, hisja jonë në këtë është përjetimi me zemër i së vërtetës dhe frytet e besimit për të cilat na ka treguar i Dërguari ﷺ.

¹⁰ Barrët që çuan në këtë bindje zëvendësohen me fuqi e cila të bartë nga ndihma hyjnore deri te lartësitë ku vetë s’do të mund të ngriheshe kurrë .

¹¹ Shpërbërja e unit në hyjnoren. Shih shënimet rreth *fanaa* (vetasgjësimit) në kaptinat e mëhershme.